



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
**Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority**

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbështetje të nenit 28 paragrafi 1.2, nenit 29 paragrafi 1, nenit 54 paragrafi 1.9, nenit 3 paragrafi 1.8, nenit 35 paragrafi 5, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 (Gazeta Zyrtare nr.88/25), nenit 51 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-028 (Gazeta Zyrtare nr. 08/01), në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2016 mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë me nr. prot. 131/14-01 të datës 10.10.2014, kundër kompanive ofertuese në tenderin për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe nxjerrë këtë:

**KONKLuzion**

1. Konstatohet se pala ka hequr dorë nga kërkesa e dorëzuar në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës,
2. Komisioni konstaton se lënda me nr. të protokollit: 131/14-01 e datës 10.10.2014 merr epilogun sikur në pikën 1 të këtij dispozitivi dhe
3. Rasti konsiderohet i mbyllur.

**ARSYETIM**

Kërkesa është parashtruar në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës nga Ministria e Drejtësisë me datë 10.10.2014, mirëpo në atë kohë Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk e kishte Komisionin funksional dhe rrjedhimisht ka qenë e pamundur të marrë ndonjë veprim ligjor lidhur me këtë çështje.

Nga Ministria e Drejtësisë me datë 30.03.2017 përmes një shkrese - deklaratë me shkrim, jemi njoftuar se procedurat në fjalë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë, janë zhvilluar dhe kanë përfunduar gjatë vitit 2015, kështu që tani pas kalimit të një periudhe të gjatë kohore, Ministria e Drejtësisë pajtohet që kjo lëndë të mbyllet.

Rasti si i tillë mbyllet sipas nenit 51 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-028 dhe Komisioni konsideron se pala ka heqë dorë nga kërkesa e saj dhe rasti merr epilogun si në dispozitiv të këtij **KONKLuzionI**.

**Këshilla juridike:**


Meqenëse pala është tërhequr nga kërkesa, konsiderojmë se dokumenti nuk ka nevojë të përmbajë këshillë juridike për palën.


Me këtë KONKLuzion të njoftohen:


- Arkiva dhe
- Ministria e Drejtësisë.

**KOMISIONI I  
AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS**



  
Valon Prestresh  
Kryetar

  
Ahmet Krasniqi  
Zv. Kryetar

  
Fatime Haziri  
Anëtare

  
Muhamed Krasniqi  
Anëtar

  
Shaqir Morina  
Anëtar